

aktivitete

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë
Aktivite 2022

Editor

Andrin Rasha
Mehmet Disha

Dizajn

Erzen Carja

ISBN 978-9928-194-92-3

Tiranë 2024

Adresa:

Rr. George W. Bush, nr. 50, Tiranë

Tel: (+355) 42 230 492

info@kmsb.al

www.kmsb.al

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë është një institucion me traditë në Shqipëri, themelimi zyrtar i të cilit daton më 1923 dhe për t'u rihapur më 1990.

Në ushtrimin e veprimtarisë së tij, si një institucion fetar e bamirës, ka si qëllim të përhapë, zgjojë dhe forcojë tek të gjithë, besimin islam, të ruajë traditën e trashëguar nga të parët tanë, të mbrojë dinjitetin, të drejtat dhe interesat e myslimanëve, të rrisë e zhvillojë ndjenjën e dashurisë e të besnikërisë ndaj fesë dhe atdheut, si dhe të ruajë e forcojë dialogun mes Komuniteteve Fetare në vendin tonë.

Në këtë botim të KMSH-së do të gjeni informacione rreth aktiviteteve kryesore dhe evenimenteve të ndryshme të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë gjatë vitit 2022. Natyrisht që përfshirja e të gjithë aktivitetit të institucionit tonë, duke përfshirë myftinitë dhe institucionet arsimore-edukative, në një vëllim të tillë do të ishte e pamundur. Prandaj, institucionet arsimore dhe myftinitë kryesore të vendit e pasqyrojnë aktivitetin e tyre në botime të veçanta.

Gjejmë rastin të falënderojmë të gjithë institucionet publike dhe jopublike, brenda dhe jashtë vendit, që nuk e kanë kursyer ndihmën dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë.

Gjithashtu shprehim gatishmërinë për të bashkëpunuar dhe për të qenë pjesë e të gjitha aktiviteteve dhe nismave në të mirë të vendit tonë dhe të shoqërisë njerëzore në përgjithësi.

Formatin e këtij botimi mund ta gjeni në faqen zyrtare të institucionit: www.kmsh.al

aktivitete

janar



Drejtori i ri i Qatar Charity Albania viziton KMSH-në

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një vizitë kortezie Drejtorin e ri të Qatar Charity Albania, z. Mahmud Abas Shakir, me rastin e emërimit të këtij të fundit në krye të shoqatës në fjalë.

Kryetari Spahiu, i uroi mirëseardhjen dhe suksese në përmbushjen e përgjegjësiave z. Abas Shakir, në emërimin e tij si drejtor i kësaj shoqate.

Më tej, të dy palët vlerësuan bashkëpunimin e deritanishëm si dhe shprehën vullnet të plotë në konkretizimin e marrëveshjeve të mëtejshme në fusha me interes të përbashkët.

Takimi u zhvillua më pas në formën e një bashkëbisedimi të lirë.





Zhvillohen Frytet e Besimit në Lushnje

Momente nga cikli i mbrëmjeve fetare “Frytet e Besimit” në qytetin e Lushnjes, ku të ftuarit, Nënkryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Taulant Bica, Këshilltari i Kryetarit për Botën Arabe, z. Jamal Seferty, dhe Hafizi Enes Hyka, u pritën nga Myftiu i Lushnjes, z. Gramos Blliku dhe besimtarët e këtij qyteti.






Përfaqësues të Qatar Charity vizitojnë KMSH-në

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim kortezie në selinë e institucionit, z. Mushaal Alhajeri, ndihmës i drejtorit të zyrave të jashtme të Qatar Charity në shtetin e Kuvajtit, i shoqëruar ky i fundit nga drejtori i Qatar Charity Albania, z. Mahmud Abas Shakir.

Bashkëbisedimi ndërmjet palëve u fokusua në marrëdhënien e deritanishme institucionale, marrëdhënie e konkretizuar në disa fusha me interes të përbashkët.

Pjesë e këtij takimi ishte edhe prezantimi i aktualitetit të dy institucioneve nga kryetari Spahiu dhe z. Alhajeri, të cilët bënë një rezymë të përgjegjësive dhe rolit të institucioneve në shoqëritë përkatëse.

Z. Alhajeri u zotua se do të angazhohet në zgjerimin e fushave të bashkëpunimit ndërmjet KMSH dhe Qatar Charity Albania në shërbim të islamit dhe familjeve në nevojë në vendin tonë.





Kryetari Spahiu pret në një takim Ambasadorin e Hollandës në Shqipëri

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim kortezie, Ambasadorin e Hollandës në Shqipëri, Reinout Vos.

Kryetari Spahiu i uroi ambasadorit Reinout Vos suksese në misionin e tij në Shqipëri dhe vlerësoi angazhimin e tij për forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve shumë të mira mes dy institucioneve tona.

Gjithashtu kryetari e njohu ambasadorin me KMSH-n, rolin dhe rëndësinë që ka ky institucion së bashku me institucionet në varësi të tij siç janë ato fetare myftinitë, xhamitë dhe institucionet arsimore si Universiteti Bedër dhe medresetë.

Ambasadori pasi falënderoi kryetarin Spahiu për pritjen, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit që shteti i tij, por edhe Evropa në tërësi i jep bashkëpunimit me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë.

Ai gjithashtu vlerësoi lidhshpinin e kryetarit Spahiu dhe rolin që ai luan për ruajtjen dhe forcimin e harmonisë ndërfaqetare në Shqipëri.



Bordi i Presidencës së KNFSH-së zhvillon mbledhjen e parë për këtë vit

Pjesë e kësaj mbledhjeje ishin drejtuesit e pesë komuniteteve fetare në vend, H. Bujar Spahiu, kryetar i Komuniteti Mysliman të Shqipërisë, Hirësi Asti, Ndihmës i Kryepeshkopit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Mons. Angelo Massafra, President i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë, H. Dede Edmond Brahimaj, kreu i Kryegjyshitës Botërore Bektashiane, Pastor Ylli Doçi, kryetar i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë.

Në këtë takim ishte gjithashtu i ftuar edhe Mons. George Frenco, ish-kreu i KNFSH-së për vitin 2020, të cilit me rastin e daljes në pension dhe largimit të tij nga Shqipëria, Bordi i Presidencës i akordoi Çmimin e Mirënjohjes me motivacionin: “Për kontributin e lartë në forcimin e frymës së dialogut ndërfetar ndër shqiptarët gjatë shërbimit në Shqipëri dhe për rolin e rëndësishëm në promovimin e vlerave universale, bashkëjetesës, harmonisë dhe bashkëpunimit ndërfetar si Kryetar i Këshilli Ndërfetar të Shqipërisë gjatë vitit 2020.”

Mbledhja vijoi më tej me rendin e ditës.

Të pranishmit gjatë kësaj mbledhjeje kanë diskutuar edhe për disa çështje të rëndësishme lidhur me angazhimet e KNFSH-së në vazhdimësi për vitin në të cilin sapo kemi hyrë.



Lançohet Instituti i Studimeve Islame “Hafiz Sabri Koçi”

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë në bashkëpunim me Kolegjin Universitar “Bedër”, zhvilluan ceremoninë e lançimit të Institutit të Studimeve Islame “Hafiz Sabri Koçi”.

Në këtë ceremoni, e cila u hap me leximin e disa ajeteve Kuranore nga Hafizi Enes Hyka, ishin të pranishëm: Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu, Rektori i Kolegjit Universitar “Bedër”, Prof. Dr. Ferdinand Gjana, nënkryetari, z. Taulant Bica, myftinj, imamë, pedagogë dhe studentë.

Ky Institut është projektuar dhe ideuar që të shërbejë në fusha të ndryshme si, studime dhe hulumtime rreth çështjeve të ndryshme teologjike, përkthime, botime, panele akademike, seminare, konferenca dhe trajnime profesionale fetare.

Pas fjalëve përshëndetëse ceremonia vijoi më tej me firmosjen e memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet dy titullarëve të lartëpërmendur, Kryetarit Spahiu dhe Rektorit Gjana.

Ky memorandum bashkëpunimi ndërmjet KMSH-së dhe Bedër përfshin zhvillimin e mësimit dhe certifikimin e studentëve që do dalin nga ky institut.

Themelimi i Institutit të Studimeve Islame është vazhdimësi e institucioneve arsimore dhe fetare të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.







aktivitete

cs

shkurt



Zv. Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës viziton KMSH-në

Zëvendës Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, z. Demian Smith, u prit në një takim nga kreu i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu.

Kryetari Spahiu i uroi z. Smith mirëseardhjen dhe e uroi për detyrën.

Bashkëpunimi i ngushtë që ekziston midis Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë ishte tema kryesore e bisedës.

Kryetari e njohu zv/ambasadorin me historikun e KMSH-s, pavarësinë e institucionit, i cili vitin e ardhshëm kremton 1 shekull mëvetësi, si dhe kontributin e çmuar që ka dhënë dhe jep Komuniteti Mysliman i Shqipërisë në harmoninë ndërfaqetare në Shqipëri.

Z. Smith falenderoi z. Spahiu për mikpritjen dhe shprehu vlerësimin e tij për leadershipin që ai ka treguar në cilësinë e Kryetarit të KMSH-s.

Gjithashtu ai vlerësoi shumë rolin që Komuniteti Mysliman luan në bashkëjetesën ndërfaqetare në Shqipëri, si dhe shprehu bindjen se pavarësia e institucioneve fetare është shumë e rëndësishme për lirinë e besimit dhe mbarëvajtjen e kësaj bashkëjetese. Takimi ishte i hapur dhe miqësor.



Zhvillohet konferenca ndërfetare me temë: “Vëllazëria në Humanizëm”

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë (KNFSH) në bashkëpunim me “Religions for Peace, Europe” zhvilluan në ambientet e “Tirana International Hotel” konferencën ndërfetare, me temë: “Vëllazëria në Humanizëm”.

Fokus i kësaj konference ishte dokumenti mbi “Vëllazërinë Njerëzore” nënshkruar nga Imami i Madh i Al-Az’har-it, Ahmad Al-Tayyeb, dhe Papa Françesku në vitin 2019.

Konferenca mbledhi së bashku krerët e 5 komuniteteve fetare zyrtare të vendit, si H. Bujar Spahiu, Kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Mons. Angelo Massarfa, President i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë, H. Dede Edmond Brahimaj, kreu i Kryegjyshatës Botërore Bektashiane, Pastor Ylli Doçi, kryetar i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë, z. Anastas Janullatos, Kreu i Kishës Ortodokse, z. Genti Kruja, Sekretar i Përgjithshëm i KNFSH dhe njëkohësisht zv/president i RfP, Europe, si dhe drejtues institucionesh, klerikë, akademikë, studiues dhe personalitete të fushave të ndryshme brenda dhe jashtë vendit tonë.

Po ashtu kjo konferencë mbledhi sëbashku edhe emra të spikatur në fushën e diplomacisë dhe dialogut ndërfetar, siç ishin Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, znj. Yuri Kim dhe i ftuari i nderit, Presidenti i “Religions for Peace, Europe”, Dr. Luigi De Silva.









Kryetari Spahiu pret në KMSH Kreun e Organizatës “Mirësi për botën”

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim prezantimi në selinë e institucionit, z. Mohummed Umar Sayed, Kreu i Organizatës “Mirësi për botën” dhe z. Ervis Xhelo, këshilltar i tij për vendin tonë.


Pasi ju uroi mirëseardhjen, kryetari Spahiu, i njohu të lartëpërmendurit me misionin, vizionin dhe rolin që ka institucioni i KMSH-së në shoqërinë shqiptare.

Ndërsa z. Mohummed Umar Sayed, prezantoi organizatën e tij, e cila ka mision përkujdesjen për shtresat në nevojë nëpërmjet ndihmave humanitare dhe mbështetjes së fëmijëve jetimë.

Gjatë këtij takimi, u ra dakord për firmosjen e një marrëveshjeje bashkëpunimi ndërmjet kësaj organizatës dhe KMSH-së për mbështetjen e aktivitetit fetar në xhami të ndryshme të vendit. Marrëveshje e cila do të firmoset në një moment të dytë.

Takimi vijoi më tej në formën e një bashkëbisedimi të lirë ku u prekën një sërë tematikash aktuale të Islamit në vendin tonë.





Ambasadorja e Suedise në Shqipëri, znj. Elsa Hastad, viziton KMSH-në

Ambasadorja e Suedise në Shqipëri, znj. Elsa Hastad, vizitoi Komunitetin Mysliman të Shqipërisë.

Znj. Hastad u prit nga Kryetari i KMSH-s, H. Bujar Spahiu.

Kryetari e falenderoi ambasadoren për vizitën dhe vlerësoi marrëdhëniet shumë të mira midis KMSH dhe Ambasadës Suedeze në Tiranë.

Fokusi i bisedës ishte miqësia midis dy vende tona dhe intensifikimi i marrëdhënieve dypalëshe në fushat me interes të përbashkët.

Ambasadorja falenderoi kryetarin Spahiu për kontributin e vazhdueshëm që jep ai personalisht dhe KMSH-ja në përhapjen e mesazhit të drejtë dhe paqësor të Islamit.

Gjithashtu ajo vlerësoi edhe kulturën e bashkëjetesës fetare në Shqipëri dhe rolin tepër të rëndësishëm që luan Komuniteti Mysliman në të.



Zhvillohet simpoziumi “Kur’ani dhe Njeriu”

Në ambientet e Akademisë së Shkencave, u zhvillua simpoziumi me temë “Kur’ani dhe Njeriu”, kolana e autorit Xhemal Balla botuar nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë (Drejtoria e Kulturës).

Të pranishëm në këtë simpozium ishin autori i kolanës, z. Xhemal Balla, Kryetari i KMSH-s, H. Bujar Spahiu, Kryegjyshi Botëror Bektashi, H. Dede Edmond Brahimaj dhe Sheh. Bujar Horasani Tarikati Kadri dhe Sheh Qemaludin Reka Tarikati Rufai.

“Profesori Xhemal Balla i përket asaj gjenerate të medresistëve që u mbrujtën me kulturë të gjerë fetare e sociale, e ruajtën dhe vunë në jetë dijen që morën në medrese.

Ai është edhe një ndër kontribuesit kryesorë në lëmin e literaturës fetare e cila i shërbeu ringritjes së islamit në Shqipëri pas viteve ‘90.

Kolana sjellë pranë lexuesit komentimin e veprës “Ajka e kuptimit të Kurani Kerimit” të dijetarit të madh shqiptar Hafiz Ibrahim Dallit.

Autori, duke u mbështetur në idetë bashkëkohore të Hafiz Dallit në përkthimin dhe komentimin e Kur’anit mbi një shekull më parë, ai e sjell atë aktual, duke analizuar problemet dhe duke i komentuar ato mbi bazën e citimeve të Kur’anit.





Përurohet Qendra Kulturore në Barbullush të Shkodrës

Nën një ceremoni të ngrohtë shpirtërore është përuar në Barbullush të Shkodrës, qendra kulturore pranë xhamisë së këtij fshati.

Në këtë ceremoni ishin të pranishëm Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, h. Bujar Spahiu, Drejtori i Vakf-Investimeve dhe Financës në KMSH, z. Edison Hoti, Myftiu i Shkodrës, z. Muhamed Sytari, drejtuesi për Ballkanin i fondacionit “Rahmeh International” në Kuvajt, z. Isa Dhewadi, drejtori i fondacionit “Mirësia”, z. Korab Kaja, drejtori i fondacionit “Mirënjohja”, z. Samed Shehu, si dhe dhjetëra imamë dhe besimtarë të zonës.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Kryetari Spahiu, pasi falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen, donatorët dhe të gjithë ata që bënë të mundur ndërtimin e kësaj qendre kulturore kaq të rëndësishme për besimtarët e fshatit Barbullush, u ndal në rëndësinë e objekteve të tilla në edukimin e brezave me frymën e vërtetë të Islamit sipas parimeve të Kuranit Famëlartë dhe traditës së bukur Profetike.

Pas fjalëve përshëndetëse, të lartëpërmendurit prenë në mënyrë simbolike shiritin e inaugurimit të kësaj qendre kulturore.

Në fund, të gjithë bashkërisht vizituan ambientet e saj.



تنمية مشروعات
والمعلماء - شاطئ البراءة
بمحافظة الإسكندرية - مصر 2017

مركز هفايخ الخير الإسلامي
تدعم محسنون من دولة الكويت
إشراف جمعية الرحمة العالمية

تنمية مؤسسة الإحسان - ألبانيا
PROMOTI E PËRZEMBATJE TE QENDRËS CHARITATIVE ME NËNTRIMIN E AGJENSIS
PUBLIKE SË SHqipërisë





aktivitete

mars



Kryetari Spahiu pret në një vizitë kortezie Ambasadorin e Kosovës

Ambasadori i Kosovës, z. Skender Durmishi, i shoqëruar nga zv. Ambasadori, z. Haxhi Bajraktari, vizituan selinë e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, ku u pritën nga kryetari i institucionit, h. Bujar Spahiu, Drejtori i Marrëdhënieve me Jashtë, z. Fejzi Shaholli dhe Drejtori i Kabinetit, z. Ejup Lila.

Pai ju uroi mirëseardhjen të pranishmëve, Kryetari Spahiu, i njohu ata me institucionin e KMSH-së, zhvillimin e tij ndër vite si dhe rolin që luan në shoqërinë shqiptare.

Ndërsa ambasadori Durmishi, në fjalën e tij, vlerësoi qendrimet dhe qasjet e KMSH-së në perçimin e mesazheve fetare dhe jo vetëm, duke kontribuar kështu në ruajtjen e harmonisë dhe balancave të tjera shoqërore në vendin tonë.

Më tej, të dy krerët, vlerësuan bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet institucioneve dhe shprehën vullnetin e tyre në intensifikimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi.



Zhvillohet edicioni i katërt i kampionatit të shahut me shoqatën e të verbërve

Drejtorja e Çështjeve Sociale pranë Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, zhvilloi edicionin e katërt të kampionatit të shahut me shoqatën e të verbërve, dega Tiranë.

Në fjalën e tij të përshëndetëse, Drejtori i Çështjeve Sociale, z. Edvin Kuçi, pasi i falenderoi anëtarët e kësaj shoqate për pjesëmarrjen, theksoi bashkëpunimin ndërjmet dy instituconeve. Gjithashtu ai vlerësoi faktin se aktivitete të tilla shërbejnë për integrimin e mëtejshëm të kësaj kategorie në shoqërinë tonë.

Më pas shahistët zunë vendet përkatëse për të filluar kampionatin, kampionat i cili zgjati rreth 3 orë me sistem grumbullimi pikësh, nga ku u pa se u zhvilluan ndeshje të forta midis konkurrentëve.

Nga pikët e grumbulluara, fitues i këtij kampionati u shpall z. Armand Hysaj.

Në fund të aktivitetit, Drejtori i Çështjeve Sociale, z. Kuçi, shpërndau çmimet fituese në vlera monetare për vendin e parë, vendin e dytë dhe të gjithë shahistët pjesëmarrës.





Akordohen 154 bursa studimi për nxënësit e medreseve

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë me mbështetje të Qendrës së Bamirësisë “Mbreti Selman” dhe nën kujdesin e Ambasadës së Arabisë Saudite në Tiranë, ka bërë të mundur akordimin e 154 bursave të studimit për nxënës të medresesë së Tiranës dhe Elbasanit.

Delegacioni nga Arabia Saudite, me në krye Ambasadorin, z. Fajsal Gazi Hifdhi dhe përfaqësuesin e qendrës humanitare, z. Abdulaziz Othman, vizituan Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, ku u pritën nga kreu i KMSH-së, H. Bujar Spahiu, dhe ku u zhvillua mbledhja inauguruese e këtij projekti.

Më pas, përfaqësues të qendrës bamirëse, të shoqëruar nga përfaqësues të KMSH-së, vizituan medresenë e Elbasanit, ku u pritën nga drejtori i saj, z. Ardit Dragoti.

Gjatë kësaj vizite, ata u njohën nga afër me ambientet e medresesë, nxënësit dhe procesin mësimor që zhvillohet rregullisht në këtë institucion.

Pjesë e axhendës ishte edhe vizita e ambienteve të medresesë së Tiranës, ku u zhvillua edhe ceremonia inauguruese e këtij projekti, me pjesëmarrjen e H. Bujar Spahiu, Kryetar i KMSH-së, z. Abdullah bin Sa'd el-Shehrij, zv. Ambasador i Mbretërisë Saudite në Tiranë, z. Abdulaziz Othman, përfaqësues i qendrës humanitare “Mbreti Selman” dhe z. Ndririm Gjimi, Drejtor i Medresesë së Tiranës.







مشروع دعم الطلاب الأيتام
PROJEKTI I DËMIMIT DHE JETIMË NË
BURSA SHKOLLIMI

مشروع دعم الطلاب الأيتام والفقراء
في مدارس المشيخة الإسلامية
الأولى
PROJEKTI I DËMIMIT DHE JETIMË NË
BURSA SHKOLLIMI





Këshilli i Përgjithshëm i KMSH-së zhvillon mbledhjen e parë për 2022-shin

Kjo mbledhje u çel me leximin e disa ajeteve Kur'anore nga Myftiu i Tiranës, z. Lauren Luli, për të vijuar më tej me fjalën hapëse të kryetarit, H. Bujar Spahiu, i cili pasi përshëndeti të gjithë anëtarët e këshillit të përgjithshëm, u ndal në ecurinë e aktivitetit fetar të KMSH-së në 6-mujorin e fundit, si dhe në angazhimin fetar që pritet nga të gjithë myftinjtë në prag të muajit të Ramazanit, për ti dhënë këtij muaji vlerën dhe rëndësinë që meriton.

Pas fjalës së kryetarit, kancelari, z. Ylli Cikalleshi, bëri një përmbledhje përpara anëtarëve të këshillit, të të gjitha vendimeve të marra që nga mbledhja e fundit e KP-së e deri te kjo e sotmja.

Pas tij, fjalën e mori kryetari i Këshillit të Përgjithshëm, z. Islam Hoxha, i cili prezantoi për të pranishmit raportin e Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm mbi ecurinë e Myftinisë së Lezhës dhe asaj të Krujës, raport nga i cili evidentohet ecuria e aktivitetit fetar, administrativ dhe ekonomik i tyre.

Më tej ishte radha e drejtorit të drejtorisë së Financës dhe Vakf- Investimeve, z. Edison Hoti, të ndante me të pranishmit zhvillimet më të fundit përsa i përket vakëfeve në rang vendi.

Në fund të kësaj mbledhjeje, Nënkryetari i KMSH-së, z. Taulant Bica, theksoi rëndësinë që ka angazhimi i të gjithë myftinive në intensifikimin e aktiviteteve dhe në përgjithësi të jetës fetare veçanërisht gjatë muajit të Ramazanit.







Fllade Ramazani në prag të këtij muaji të bekuar

Myftinia e Kavajës zhvilloi programin festiv “Fllade Ramazani” me rastin e afrimit të muajit të Bekuar të Ramazanit.

I zhvilluar në qendrën kulturore të Rogozhinës, ky aktivitet mbledhi së bashku dhjetëra besimtarë e besimtare, përfaqësues të pushtetit lokal, imamë e hoxhallarë të shumtë, veçojmë këtu, H. Bujar Spahiu, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Besnik Leçini, Myftiu i rrethit Kavajë, z. Edison Memolla, kryetari i Bashkisë Rogozhinë, etj.

Programi nisi me leximin e disa ajeteve Kuranore, për të vijuar më tej me fjalën përshëndetëse të Kryetarit Spahiu, i cili pasi falenderoi organizatorët për këtë tubim kaq domethënës, u ndal në kontekstin fetar e social të këtij muaji kaq të madh, nga i cili na ndajnë vetëm pak ditë.

Më tej fjalën e mori Myftiu i Kavajës, z. Leçini, i cili shprehu falenderim të veçantë për organizatorët dhe pjesëmarrësit në këtë program kaq të dobishëm në edukimin dhe ndezjen e një atmosfere shpirtërore të veçantë në prag të muajit të Bekuar të Ramazanit për besimtarët e Rogozhinës.

Më tej programi vazhdoi me ligjërata të tjera fetare.





Zhvillohet programi fetar “Mirë se vjen o Muaj i Bekuar”

Në kuadër të afrimit të muajit të Bekuar të Ramazanit, Myftinia e Tiranës, zhvilloi një program fetar në ambientet e “Baraku Event” me titull: “Mirë se vjen o Muaj i bekuar”.

Ky program mbledhi së bashku besimtarë të shumtë, imamë e myezinë të kryeqytetit, veçojmë këtu pjesëmarrjen e Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu.

Nën një atmosferë të ngrohtë shpirtërore, aktiviteti u hap me leximin e disa ajeteve Kuranore nga Hafizi Enes Hyka, për të vijuar më pas me fjalën përshëndetëse të Myftiut të Tiranës, z. Lauren Luli, i cili falenderoi të pranishmit për pjesëmarrjen dhe u ndal në veçoritë e muajit të Ramazanit si dhe mënyrën sesi duhet të presim e ta kalojmë ne si besimtarë.

Më tej, të pranishmit i përshëndeti edhe Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, h. Bujar Spahiu, i cili pasi falenderoi organizatorët për këtë event kaq të rëndësishëm, ndau me të pranishmit rëndësinë e këtij muaji të madh.

Programi vijoi më tej me referimet e imamëve të nderuar të kryeqytetit, si: “Ramazani, muaji i Kuranit” nga zv. Myftiu Bilal Teqja, “Ramazani dhe devotshmëria” nga zv. Myftiu Erjol Haxhiu, “Planifillimi i një ramazani të suksesshëm” nga imami Elton Karaj dhe “Ramazani, muaji i bujarisë dhe i solidaritetit” nga imami Shpëtim Serjani.









Lançohet fushata e bamirësisë në ndihmë të mbi 5.500 familjeve në nevojë

Në prag të Muajit të Bekuar të Ramazanit, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, në bashkëpunim me Qendrën Bamirëse dhe Humanitare “Mbreti Selman” dhe Ambasadën e Arabisë Saudite në Tiranë, hapën fushatën e bamirësisë në ndihmë të mbi 5.500 familjeve me vështirësi ekonomike në mbarë vendin tonë.

Të pranishëm ishin Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Myftiu i Tiranës z. Lauren Luli, zëvendës ambasadori i Arabisë Saudite në Tiranë, Abdullah bin Sa’d el-Shehri dhe përfaqësues të Qendrës Humanitare “Mbreti Selman”.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Kryetari Spahiu, u shpreh se ne jemi të vetëdijshëm se nevojat janë më të mëdha, por sigurisht jemi po aq të vetëdijshëm se nisur nga konteksti aktual, ku një krizë gati globale ushqimore ka prekur vende edhe më të pasura se vendi jonë, është një ndihmë që do të zbusë sado pak këtë gjendje.

Ndërsa z. Abdurrahman el Zebe, përfaqësuesi i qendrës financuese të këtij projekti, theksoi se falë këtij kontributi të vyer të Mbretit Selman bin Abdulaziz, nëpërmjet qendrës humanitare me të njëjtin emër, rreth 5.500 familje në nevojë do të kenë një ndihmë të konsiderueshme ushqimore për muajin e bekuar të Ramazanit.

Fushata konsiston në shpërndarjen e pakove me ndihma të ndryshme ushqimore. Fillimisht pakot me nga 80 kg ushqime secila, do t’ju dorëzohen përfaqësuesve të KMSH-së në çdo rreth të vendit, më pas këta të fundit do t’jua shpërndajnë familjeve në nevojë.

مركز السلطان
Ibreti Selman
سلة إطفام في جمهوريت
e Shqipërisë për vitin 2022
(it)

ربة أباتنيا للعام 2022م (سلال رمضانية)
Projekti i shportës së ushqimit në Republikën
(shportat e Ramazanit)



Zhvillohet tribuna fetare me temë: “Mirë se vjen Ramazan” në xhaminë e qendrës së Koplikut

Në këtë tribunë, krahës mikëpritësit, Myftiut të Malësisë së Madhe, z. Edmir Smajlaj, mori pjesë Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu dhe imami nga Shkupi, Dr. Zekeria Bajrami.

Tribuna u hap me këndimin e ajeteve kuranore nga imami i xhamisë së qytetit të Burrelit, si mysafir i myftinisë Malësi e Madhe, z. Vladimir Haxhia.

Më pas, Myftiu Smajlaj hapi tribunën duke iu uruar mirë se ardhjen të ftuarve dhe besimtarëve të pranishëm.

Kryetari Spahiu priu faljen e namazit të ikindisë dhe mbajti një fjalë përshëndetëse në lidhje me muajin e begatë të Ramazanit. Rëndësia e këtij muaji, adhurimi i Zotit me përkushtim dhe ana sociale e Ramazanit, ishin disa nga temat që kryetari ndau me besimtarët e shumtë të pranishëm në ambientin e xhamisë.

Në fund, imami Bajrami gjate fjalës së tij u ndal në vlerën e agjërimit si dhe në bashkëpunim ndërmjet myslimanëve, si jashtë Ramazanit, ashtu edhe gjatë Ramazanit.

Myftinia e Malësisë së Madhe i akordoi çertifikatë mirënjohje, imamit Bajrami, për kontributin e dhënë në këtë myftini, çertifikatë të cilën ia dorëzoi Kryetari i Komunitetit Mysliman, H. Bujar Spahiu.









Swiss Barakah Charity vizitë në KMSH

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, h. Bujar Spahiu, priti në një takim në selinë e institucionit, përfaqësuesin e fondacionit “Swiss Barakah Charity”, z. Mohamad Axhemi.

Gjatë këtij takimi u diskutua për intensifikimin e marrëdhënieve ndërmjet dy institucioneve në shërbim të islamit dhe myslimanëve në vendin tonë.

Në fjalën e tij, kryetari Spahiu, vlerësoi rolin e Swiss Barakah në fushën e bamirësisë në mbarë botën dhe së fundmi edhe në vendin tonë.

Ndërsa z. Axhemi shprehu vlerësimet e tij për kontributin e vazhdueshëm që jep Komuniteti Mysliman i Shqipërisë në shërbim të nevojtarëve dhe myslimanëve, si dhe bashkëpunimin që institucioni ynë i ka ofruar fondacionit në fjalë.

Gjatë vizitës së tyre në vendin tonë, të shoqëruar nga myftiu i Gramshit z. Ermir Gjana, përfaqësuesit e Swiss Barakah u erdhën në ndihmë rreth 125 familjeve nevojtare besimtare si dhe disa spitaleve e qendrave kulturore për fëmijë.





KMSH dekoron me titullin “Hafiz Ali Korça”, Prof. Dr. Ferdinand Gjanën, rektor i KU Bedër

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë dekoron me titullin “Hafiz Ali Korça”, Prof. Dr. Ferdinand Gjanën, Rektor i Kolegjit Universitar “Bedër”.

Me rastin e përfundimit të mandatit të Prof. Gjanës si rektor i këtij institucioni që nga themelimi në prill të vitit 2011, u zhvillua edhe ceremonia e lamtumirës së tij, ceremoni në të cilën ishte vetë Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i cili i dorëzoi z. Gjana, titullin “Hafiz Ali Korça”, me motivacionin: “Për kontributin e çmuar në fushën e arsimit, veçanërisht në hedhjen e themeleve dhe ngritjes së Kolegjit Universitar Bedër.”

Në këtë ceremoni përshëndetën Dr. Erlis Cela, Shef i Departamentit të Shkencave të Komunikimit pranë këtij institucioni, Dekani i Fakultetit të Shkencave Humane, Prof. Assoc. Dr. Rahim Ombash, ish-kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Skender Bruçaj si dhe Kryetari aktual H. Bujar Spahiu, të cilët vlerësuan figurën e Prof. Gjanës dhe kontributin e tij ndër vite në ecurinë e institucionit.

Më tej, Kryetari Spahiu i dorëzoi Prof. Gjanës titullin e nderit në emër të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.



aktivitete

prill



Zhvillohet programi festiv në Elbasan kushtuar Muajit të Ramazanit

Aktiviteteve të myftinive të Shqipërisë “Mirë se vjen Ramazan”, iu shtua edhe ai i Myftinisë së Elbasanit.

Krahas Myftiut të Elbasanit, z. Agim Duka, dhe të ftuarve të tjerë pjesëmarrës, këtë aktivitet e përshëndeti me fjalën e tij edhe Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu.





KMSH shtron iftarin e parë të Ramazanit 2022

Komuniteti Mysliman shtroi iftarin e parë të këtij Ramazani.

Në këtë iftar morën pjesë besimtarë të shumtë, personalitete të shoqërisë civile, gazetarë, politikanë, ndër ta, Kryetari i Bashkisë së Tiranës, z. Veliqaj, Kryetari i Grupit Parlamentar të PS, z. Taulant Balla, ministret Spiropali dhe Muzhaqi.

Ishin të pranishëm gjithashtu diplomatë të vendeve të ndryshme mike.

Iftari i parë, natën e parë të Ramazanit, është prej vitesh një traditë e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

Gjithashtu ky iftar ishte një rikthim pas ndërprerjes për shkak të pandemisë covid-19.








Delegacioni i KMSH-së vizitë në kompleksin e mirënjohur për Botimin e Kur'anit “Mbreti Fehd”

Kryetari i KMSH, H. Bujar Spahiu, së bashku me delegacionin e tij zhvilloi një vizitë pune pranë Kompleksit të mirënjohur “Mbreti Fehd” për Botimin e Kuranit, në Medine ku u prit nga përfaqësues të lartë të kompleksit, me në krye z. Khalid Suleiman el-Nefisi, Sekretar i Përgjithshëm i qendrës në fjalë.

Gjatë takimit kryetari Spahiu i njohu mikpritësit me institucionin e KMSH dhe sfida që ai përballon çdo ditë në përcjelljen e mesazhit të islamit në shoqërinë shqiptare. Po ashtu kryetari Spahiu i njohu ata me sfidat që ka kaluar Komuniteti Mysliman i Shqipërisë në rrugëtimin 100 vjeçar të tij që prej pavarësisimit.

Nga ana e tij, z. el-Nefisi e njohu kryetarin Spahiu me Kompleksin “Mbreti Fehd” dhe traditën e shkëlqyer të kësaj shtëpie botuese të Kuranit Famëlartë, kontributin mbarëbotëror që ajo ka në botimin dhe përhapjen e kopjeve të librit të shenjtë në mbi 70 gjuhë e 80 versione si dhe zhvillimin e saj të vazhdueshëm për t’ju përgjigjur nevojave të kohës.

Më tej, u zhvillua një mbledhje ndërmjet dy delegacioneve, ku u diskutua rreth marrëdhënieve dypalëshe dhe bashkëpunime në projekte të mundshme në të ardhmen për t’i shërbyer Kuranit Famëlartë në Shqipëri.





Shpërndahen 25 ton hurma arabe për agjëruesit në mbarë vendin tonë

Me rastin e muajit të bekuar të Ramazanit, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë shpërndau 25 ton hurma arabie për besimtarët dhe agjëruesit dhuratë nga mbreti i Arabisë Saudite, Selman bin Abdulaziz, për popullin shqiptar, e sjellë në vendin tonë nga Qendra Mbreti Selman për Bamirësi dhe Ndihma Humanitare.

Në ceremoninë e inaugurimit morën pjesë z. Bujar Spahiu, kryetar i KMSH, z. Faisal Ghazi Hifdhi, ambasador i Mbretërisë së Arabisë Saudite në vendin tonë dhe Abdulmexhid el-Kahtani, përfaqësues i qendrës bamirëse në fjalë.

Gjatë fjalës së tij përshëndetëse, kryetari Spahiu falënderoi bamirësit me në krye mbretin Selman bin Abdulaziz për këtë dhuratë të vyer dhe ambasadën e Arabisë Saudite në vendin tonë për koordinimin, si dhe i siguroi të gjitha palët për angazhimin maksimal të KMSH-së në bashkëpunime si ky me mbretërinë e Arabisë Saudite dhe ambasadën e saj në vendin tonë.

Ndërsa ambasadori saudit në vendin tonë, z. Hifdhi, u shpreh se nisma si kjo janë shenjë e qartë e solidaritetit dhe dashamirësisë që Mbretëria e Arabisë Saudite ka kundrejt vendeve mike dhe se vendi ynë Shqipëria bën pjesë në krye të këtyre vendeve.





Ambasadorët e dy vendeve mike si Gjermania dhe Franca vizitojnë KMSH-në

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim dy ambasadorët e dy vendeve mike.

Znj. Elisabeth Barsacq, Ambasadore e Francës në Shqipëri dhe z. Peter Zingraf, Ambasadori i Gjermanisë në vendin tonë.

Kryetari Spahiu i njohu dy diplomatët e rëndësishëm evropianë me aktualitetin në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, përgatitjet për festimin e Fiter Bajramit dhe situatën e përgjithshme.

Ai falenderoi ambasadorët për vizitën dhe vuri theksin te marrëdhëniet e shkëlqyera që Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ka me të dyja vendet që përfaqësojnë ata.

Ambasadorët nga ana e tyre vlerësuan lidershipin e z. Spahiu në drejtimin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, si edhe përkushtimin e tij të veçantë për të ruajtur e forcuar më tej dialogun dhe harmoninë fetare në vend.

Të dy ambasadorët ishin të një mendje sa i përket vlerësimit për intergjetetin e lartë dhe rolin të përbërësor që Komuniteti Mysliman luan në shoqërinë shqiptare.





Fondacioni “Mirënjohja” dhuron paisje elektronike të ndryshme për myftinitë e vendit

Fondacioni “Mirënjohja” në bashkëpunim me Ambasadën e Kuvajtit, i dhuruan Komunitetit Mysliman të Shqipërisë një donacion me paisje elektronike të ndryshme për myftinitë e vendit, me qëllim rritjen e performancës në punët e përditshme.

Dorëzimi i këtyre paisjeve ju bë drejtorit të Financës dhe Vakf-Investimeve në KMSH, z. Edison Hoti nga përfaqësuesi i Fondacionit “Mirënjohja”, z. Albert Shehu.

Ky donacion konsiston në kompiutera zyre, printera, dron, aparat fotografik dhe aksesorë të tjerë të nevojshëm.



aktivitete

maaj

Zhvillohet ceremonia e faljes së Fitër Bajramit 2022 në sheshin “Skënderbej”, Tiranë

Mijëra besimtarë myslimanë falën namazin e Fitër Bajramit në sheshin “Skënderbej” në Tiranë dhe mijëra të tjerë në sheshet kryesore të çdo qyteti të vendit.

Programi i Fitër Bajramit filloi që në orët e para të mëngjesit me faljen e namazit të sabahut në shesh, për të vijuar më pas me këndimin e një pjese nga Kurani Famëllartë, të cilën e përcolli për besimtarët e pranishëm hafizi Besmir Krruta.

Më tej ishte radha e fjalës përshëndetëse të Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i cili përcolli mesazhe të shumta urimi e solidariteti.

Më tej Kryetari Spahiu u ndal edhe në rrugëtimin e institucionit, rrugëtim ky i cili vitin e ardhshëm kremton 100-vjetorin e tij.

Programi vijoi më tej me fjalën përshëndetëse të Nënkryetarit të KMSH-së, z. Taulant Bica, i cili ndau me mijëra besimtarët e pranishëm mesazhe të shumta paqeje dhe solidariteti.

Më tej u bë falja e namazit të bajramit, ku mijëra besimtarët e mbledhur në shesh i priu Kryetari i Komunitetit, H. Bujar Spahiu, për të vazhduar më pas me hutben e Fitër Bajramit e cila u mbajt nga Myftiu i Tiranës, z. Lauren Luli.

Gjatë hutbes, Myftiu Luli, u lut për më shumë paqe, kënaqësi, gëzim dhe harmoni në shoqërinë tonë.











Personalitete e përfaqësues institucionesh urojnë besimtarët për Fitër Bajram

Menjëherë pas përfundimit të faljes së Fitër Bajramit në “Sheshin Skënderbej”, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë hapi dyert për të pritur vizitat tradicionale me rastin e kësaj feste.

Për të përcjellë mesazhet e urimit në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë ishin Presidenti i Republikës, z. Ilir Meta, Kryebashkiaku i Tiranës, z. Erion Veliaj, Kryetari i Komitetit Shtetëror për Kultet, z. Klodian Bulku, krerët e komuniteteve të tjera fetare të vendit, si dhe drejtues të institucioneve shtetërore, lokale, përfaqësues të subjekteve politike, trupit diplomatik në Tiranë, personalitete të jetës publike, të fushës së artit, medias, biznesit, etj.

Në mesazhet e tyre ata shprehën urimet dhe përshëndetjet më të përzemërta për besimtarët myslimanë të cilët me Fitër Bajramin mbyllin kështu maratonën 30-ditore të muajit të bekuar të Ramazanit.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë falënderon të gjithë ata që morën pjesë në këto vizita si dhe të gjithë shqiptarët që kanë dërguar mesazhe urimi me rastin e kësaj feste.









Ambasadori i Italisë në Tiranë viziton KMSH-në

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim, z. Fabrizio Bucci, Ambasadori i Italisë në Tiranë.

Kryetari Spahiu e felenderoi ambasadorin Bucci për vizitën dhe e njohu atë më historinë e KMSH, aktivitetin fetar dhe veçanërisht i foli për harmoninë dhe mirëkuptimin e ndërsjelltë që ekziston midis krerëve fetar dhe besimtarëve ndërmjet tyre në Shqipëri.

Ambasadori Bucci vlerësoi shumë rolin e KMSH dhe kryetarit Spahiu në ruajtjen dhe percjelljen e këtyre mesazheve paqësore në shoqëri.

“Shqipëria është vend mik i Italisë dhe ne na gëzon fakti që kemi një bashkëpunim të shkëlqyer në tërësinë e marrëdhënieve tona midis dy vendeve, por edhe me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, me të cilin kemi një marrëdhënie të veçantë” - tha ambasadori Fabrizio Bucci.





Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu viziton Papa Françeskun

Me ftesë të Papa Françeskut, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, vizitoi shtetin e Vatikanit, nga ku u prit në një audiencë të veçanatë nga Papa.

Takimi kokë më kokë midis Papa Françeskut dhe Kryetarit Spahiu zgjati për më shumë se 30 minuta.

Bashkëjetesa paqësore ndërmjet feve në Shqipëri, Dokumenti i Vëllazërisë Njerëzore i nënshkruar midis Imamit të Madh të Al-Az'har, Ahmed Tajib dhe Papa Françeskut, ishin temë kryesore e bisedës që z. Spahiu zhvilloi gjatë audiencës me Papën.

Dy krerët e lartë ndanë mendime të njëjta për rolin që luan feja në marrëdhëniet ndërnjerëzore, kontributin që ajo luan për ruajtjen e këtyre vlerave, sidomos në mbrojtjen e familjes, si qelizë themelore e shoqërisë, rol të cilin ata e vlerësuan si të pa çmueshëm.

Papa vlerësoi rolin e veçantë që luan Kryetari Spahiu në promovimin dhe përhapjen kudo në Shqipëri të Dokumentit të firmosur në Abu Dabi mbi vëllazërimin njerëzor.

Kryetari Spahiu gjatë audiencës i kërkoi Papa Françeskut mbështetjen e shtetit të Vatikanit për pavarësinë e Kosovës.

Të dy krerët shkëmbyen edhe dhuratat e rastit në fund të takimit.







Zhvillohet konferenca ndërkombëtare “Uniteti Islam - Koncepti, Mundësitë dhe Sfidat”

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, mori pjesë në konferencën ndërkombëtare me temë “Uniteti Islam - Koncepti, Mundësitë dhe Sfidat”, e cila u organizua nga Këshilli Botëror i Komuniteteve Myslimane, nën kujdesin e Ministrisë Emiratase për Tolerancën dhe Bashkëjetesën, në Abu Dabi, në datat 8-9 maj, me ftesë të posaçme nga Ali Rashid al-Nuajmi, kryetar i KBKM.

Gjatë konferencës në fjalë, kryetari Spahiu përfaqësoi Komunitetin Mysliman të Shqipërisë duke zhvilluar takime me kryetarë komunitetesh myslimane dhe ministra të çështjeve fetare nga shumë vende të botës.

Gjatë këtij aktiviteti, z. Spahiu u shoqërua nga kancelari i KMSH, z. Ylli Cikallesi, drejtori i Vakf-Investimeve, z. Edison Hoti, drejtori i Marrëdhënieve me Jashtë, z. Fejzi Shaholli, këshilltari i tij për marrëdhëniet me vendet arabe, z. Jamal al-Safarti dhe myftiu i Gramshit, z. Ermir Gjana.







Muslim Communities Council





Takim pune me qendrën “Hedayah” në Abu Dabi

Delegacioni përfaqësues nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë zhvilloi një mbledhje pune në qendrën “Hedayah”, organizatë ekselence për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm me qendër në Abu Dhabi të Emirateve të Bashkuara Arabe dhe me aktivitet intensiv në mbarë botën.

Gjatë kësaj mbledhjeje përfaqësuesit e KMSH bënë një prezantim të institucionit tonë si dhe shpjeguan përpjekjet e panumërta të tij në luftimin e ekstremizmit dhe radikalizmit për vite me radhë në mbarë vendin.

Ndërsa pala mikpritëse prezantoi aktivitetin e qendrës Hedayah dhe vizionin që ajo përpiqet të përcjellë në shoqëritë e mbarë botës, si dhe u diskutua mundësia e intensifikimit të bashkëpunimeve ndërmjet dy institucioneve.


Gjatë këtij aktiviteti delegacioni i KMSH kryesohej nga Sekretari i Përgjithshëm, z. Ylli Cikallesi, drejtori i Marrëdhënieve me Jashtë, z. Fejzi Shaholli, drejtori i Vakf-Investimeve, z. Edison Hoti, si dhe myftiu i Gramshit, z. Ermir Gjana.





Kryetari Spahiu zhvillon takime të shumta me prijës fetarë nga e gjithë bota

Gjatë pjesëmarrjes në konferencën ndërkombëtare me temë “Uniteti Islam – Koncepti, Mundësitë dhe Sfidat”, e cila u organizua nga Këshilli Botëror i Komuniteteve Myslimane, nën kujdesin e Ministrisë së Emirateve për Tolerancën dhe Bashkëjetesën, në Abu Dabi, në datat 8-9 maj, me ftesë të posaçme nga Ali Rashid al-Nuajmi, kryetar i KBKM, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu takoi dhe bisedoi me shumë prijës zyrtarë shtetesh dhe krerë fetarë nga vende të ndryshme të botës.







Kryetari Spahiu pret në një takim drejtuesit e Medresesë Shkodër

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim punë Drejtorin e Medresesë së Shkodrës z. Kujtim Dervishi, Drejtoreshën e Medresesë së Durrësit, znj. Neriman Gjinali, e shoqëruar nga koordinatori, z. Nasuf Hoxha dhe sekretarja e medresesë Durrës, znj. Fatjona Zeneli.

Drejtoreshit e medreseve e njohën kryetarin Spahiu me ecurinë e punëve në këto institucione arsimore, evidentuan problematikat dhe vendosën prioritetet për vitin e ardhshëm shkollor.

Kryetari Spahiu i falenderoi për vizitën si dhe u shprehur atyre gjithë mbështetjen e tij personale dhe të institucionit për t'iu gjendur pranë, ashtu siç edhe ka ndodhur deri më tani, për çdo problematikë.

“Medresetë janë krenaria e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe vëmendja ime ndaj tyre është tepër e veçantë dhe do të vazhdojë të mbetet e tillë” - tha z. Spahiu ndër të tjera.

Kryetari në këtë takim u shoqërua nga Drejtori i Kulturës, z. Dorian Demejta.





Zhvillohen Frytet e Besimit në xhaminë e Botanikut

Për të ligjëruar për besimtarët e mbledhur me këtë rast ishin, Nënkryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Taulant Bica, i cili referoi mbi lidhjen e besimtarit me Allahun (xh.sh) dhe Profetin Muhamed (a.s), imami i xhamisë Et'hem Beu, Elton Karaj, me temën: “Veçoritë e besimtarit që përmenden në suren Ra’d”, dhe imami Abdullah Ziba, i cili lexoi për të pranishmit disa vargje nga Kurani Famëllartë.

Të partëpërmendurit u pritën nga imami i xhamisë “Botaniku”, Aorel Senja dhe xhemati i kësaj zone.

Në fund të programit të pranishmit u bënë pjesë e koktejlit të organizuar me këtë rast.





de

aktivitete

ershor

Ekstremizmi Fetar - Pikënisjet Ideologjike dhe Strategjitë e Përballimit

Një delegacion përfaqësues i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë mori pjesë në konferencën ndërkombëtare me temë “Ekstremizmi Fetar - Pikënisjet Ideologjike dhe Strategjitë e Përballimit”.

Konferenca u organizua nga Myftinia e Egjiptit, nën kujdesin e kryeministrit të vendit Mustafa Madbouli dhe u zhvillua në Kairo, në datat 7-9 qershor.

Komuniteti Mysliman ishte pjesë e kësaj konference me ftesë të posaçme nga myftiu i Egjiptit Prof. Dr. Sheuki Al-lam dhe u përfaqësua nga Myftiu i Beratit, z. Baftjar Këllezi, i shoqëruar nga koordinatori i Marrëdhënieve me Botën Arabe, z. Ermir Gjana.

Gjatë këtij aktiviteti delegacioni i KMSH zhvilloi takime me kryetarë komunitetesh myslimane dhe ministra të çështjeve fetare nga shtete të ndryshme pjesëmarrëse.





Mbyllet fushata e dhurimit të gjakut në ndihmë të fëmijëve talasemikë

Ftesës së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për të dhuruar gjak në ndihmë të fëmijëve talasemikë, ju përgjigjën jo vetëm stafi i institucionit por edhe dhjetëra besimtarë e qytetarë të ndryshëm të Tiranës.

Që nga nisja e saj në muajin Maj, kjo fushatë u shtri në xhami të ndryshme të Kryeqytetit, ku besimtarë të shumtë dhanë kontributin e tyre në këtë kauzë kaq fisnike, për tu mbyllur sot në ambientet e institucionit.

Talasemia është një ndër sëmundjet më të shpeshta të gjakut, që ka përhapje masive edhe në Shqipëri, duke përfshirë më së shumti fëmijët.

Nevojat e tyre janë më të shumta se sa dhurimet vullnetare të gjakut në vendin tonë, ndaj Komuniteti Mysliman fton të gjithë besimtarët ti bashkëngjiten kësaj kauzë jetike për fëmijët të cilët vuajnë nga kjo sëmundje.

Allahu (xh.sh) i shpërbleftë të gjithë ata që dhuruan!





Niset grupi i parë i haxhinjve nga Shqipëria

Mbrëmjen e sotme u nis për në vendet e shenjta grupi i parë i haxhinjve nga Shqipëria.

Në përcjelljen e tyre në Aeroportin 'Nënë Tereza' ishte prezent edhe Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu.

Z. Spahiu i uroi atyre rrugë të mbarë dhe me lutjet për të patur Haxh të pranuar, kërkoi edhe lutjet e tyre gjatë qëndrimit në vendet e shenjta.

Këtë vit shkuan për Haxh rreth 570 besimtarë nga Shqipëria.

I gjithë organizimi i këtij udhëtimi i është mandatuar nga Kryesia e KMSH Myftiut të Tiranës, z. Lauren Luli, i cili pati edhe mbështetjen e Myftiut të Kavajës, z. Leçini si dhe staf tjetër mbështetës, duke përfshirë edhe stafin mjekësor.



aktivitete

korrik



KU Bedër diplomon brezin e 9-të të studentëve

Kolegji Universitar Bedër diplomoi brezin e nëntë të studentëve në 8 programe studimi bachelor dhe 10 programe master. 247 studentë mbyllën me sukses rrugëtimin akademik.

Të pranishëm në ceremoni ishin prindër, familjarë, drejtues të institucioneve të ndryshme, të ftuar, pedagogë dhe anëtarë të tjerë të Kolegjit Universitar Bedër, etj.

Fjalën e hapjes e mbajti Rektori i “Bedër”, Prof. Dr. Gjergj Sinani, i cili uroi studentët dhe shprehu bindjen se ata do të jenë një vlerë e shtuar për të gjithë. Ai falenderoi dhe stafin për punën e kryer me aq përkushtim në këto vite, duke mundur diplomimin e studentëve.

I ftuar nderi në ceremoni ishte Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i cili vlerësoi rezultatet e arritura nga Kolegji Univeristar Bedër. Në fjalën përshëndetëse Kryetari i KMSH-së i bëri thirrje të drejtëpërdrejtë të rinjve të sapodiplomuar që të mos e braktisin vendin e tyre, por kontributin ta japin për zhvillimin e tij.

Më pas ceremonia vazhdoi me përshëndetjet e dekanëve të fakulteteve.

Të ndarë sipas departamenteve, studentët u ngjitën në skenë për të marrë diplomat dhe ceremonia u mbyll me hedhjen tradicionale të kapeles.







Ceremonia e faljes së Kurban Bajramit në sheshin “Skënderbej”

Mijëra besimtarë myslimanë mbushën sheshin “Skënderbej” dhe gjithë sheshet e xhamitë e vendit për faljen e Kurban Bajramit.

Programi i Kurban Bajramit në kryeqytet filloi që në orët e para të mëngjesit me faljen e namazit të sabahut, për të vijuar më pas me këndimin e një pjese nga Kurani Famëlarhtë, të cilën e përcolli për besimtarët e pranishëm hafizi Enes Hyka.

Ceremonia vijoi me fjalën përshëndetëse të Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i cili përcolli mesazhe të shumta urimi e solidariteti.

“Sot në vendin tonë dhe mbarë globin ka festë, ka bajram. Kurban Bajrami është festa që simbolizon dashurinë dhe përkushtimin e robit të devotshëm ndaj Zotit të gjithësisë.” - nisi fjalën e tij z. Spahiu.

Më tej ai përcolli mesazhet e simbolikës së Kurban Bajramit dhe la disa mesazhe të rëndësishme sociale për familjen, rininë dhe rëndësinë e ndërtimit të një shoqërie të drejtë.

Pas faljes së namazit, në orën 06:05, të cilin e priu kryetari Spahiu, programi vijoi më tej me Hutben e Bajramit që u mbajt nga Nënkryetari i KMSH-së, z. Taulant Bica.

Ai ndau me mijëra besimtarët e pranishëm mesazhe të shumta paqeje dhe solidariteti.

“Sot është dita e bashkimit, shkrirjes së zemrave, lagimit të mërive, solidaritetit dhe mirëkuptimit njerëzor. Në këtë ditë gëzimi dhe lumturia hyn në çdo shtëpi të pasuri apo të varfëri, jetimi e të pastrehi. Edhe ai që nuk ka mundësi të bëjë kurban sot, le të dhurojë një buzëqeshje” – tha ai gjatë fjalës së tij.

Më pas besimtarët e pranishëm në shesh u shpërndanë për të festuar me familjet dhe të afërmit e tyre.







Dhjetëra personalitete urojnë besimtarët për Kurban Bajram

Pas përfundimit të faljes së Kurban Bajramit në “Sheshin Skënderbej”, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë hapi dyert për të pritur vizitat tradicionale me rastin e kësaj feste.

Për të përcjellë mesazhet e urimit në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë ishin Krerët e Komuniteteve fetare në Shqipëri.

Të pranishëm ishin, gjithashtu, Presidenti i Republikës, z. Ilir Meta, Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, znj. Yuri Kim, Nënkryetari i Bashkisë së Tiranës, z. Andi Seferi, Prefekti i Tiranës, z. Afrim Qendro, Kryetari i Komitetit Shtetëror për Kultet, z. Klodian Bulku së bashku me dy anëtarët, z. Servet Gura dhe z. Lirim Neziraj , Kryetarja e LSI, znj. Monika Kryemadhi, Ambasadori i Kosovës në Tiranë, z. Skënder Durmishi, Nunci Apostolik, imzot Luigi Bonazzi, Ambasadori i Ukrainës, ambasadorët të BE-së, vendeve arabe, drejtues të institucioneve shtetërore qendrore dhe lokale, besimtarë, përfaqësues të shoqatave të ndryshme, akademikë, personalitete të jetës publike etj.

Në mesazhet e tyre ata i përcollën Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, urimet dhe përsëritjet më të përzemërta për të dhe gjithë myslimanët me rastin e Kurban Bajramit, festë e cila i fton besimtarët të shtojnë dashurinë për Zotin dhe për njëri-tjetrin.







Zhvillohet shkolla verore për dhjetëra të rinj nga i gjithë vendi

Rreth 65 të rinj të shkollave të mesme dhe fillore nga qytete të ndryshme të Shqipërisë, u bënë pjesë e kampingut veror të organizuar në Medresenë e Tiranës.

Ky kamping, i ndarë në dy grupe, u zhvillua në periudhat, 11-17 dhe 17-23 Korrik.

Me kontributin e studentëve vullnetar, anëtar të Forumit Rinor Mysliman Shqiptar, u bë e mundur zhvillimi i mësimëve në lëndë të ndryshme, si: Kuran, Ilmihal, Anglisht, Logjikë dhe Informatikë. Krahas mësimëve, pasditja ishte e rezervuar për aktivitete argëtuese si: Latitude, Pishina, VR Games, Light Strike, Futboll, Kinema e shumë të tjera.

Falënderojmë të gjithë imamët dhe myftinjtë të cilët kontribuan në ecurinë e këtij programi dy javor, po ashtu edhe prindërit të cilët na besuan fëmijët e tyre.

Mbarëvajtja e këtij organizimi u ndoq hap pas hapi nga përfaqësuesi i zyrës së rinisë në KMSH, Qëndrim Zogaj.









Atasheu Fetar i Mbretërisë së Arabisë Saudite në Bosnje-Hercegovinë viziton KMSH-në

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në zyrën e tij në një takim zyrtar, Shkëlqesinë e Tij, Amir al-Anezi, Atashe Fetar i Mbretërisë së Arabisë Saudite në Bosnje-Hercegovinë. Z. Spahiu e njohu z. Anezi me aktualitetin e institucionit të KMSH-së dhe një historik të shkurtër rreth tij.

Ndërsa z. Anezi, i cili vizitoi KMSH-në me porosi të posaçme të Shkëlqesisë së Tij, Abdul-Latif bin Abdul-Aziz Al-Sheikh, ministër për Çështjet Fetare në Mbretërinë e Arabisë Saudite, përcolli përshëndetjet më të përzemërta për kryetarin Spahiu dhe stafin e tij, duke veçuar Komunitetin Mysliman të Shqipërisë si një ndër bashkësitë fetare më tradicionale dhe me peshë në rajonin e Ballkanit.

Më tej, dy palët u fokusuan në marrëdhëniet e shkëlqyera që ekzistojnë ndërmjet KMSH-së dhe Ministrisë së Çështjeve Fetare në Arabinë Saudite, si dhe në zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit të firmosur ndërmjet dy krerëve në vjeshtën e vitit 2021, duke programuar bashkëpunime të reja në të ardhmen e afërt.



Një tjetër vakëf i ri i shtohet fondit të pronave të KMSH-së

Ky vakëf është një hotel në bregdetin e Vlorës, 'Hotel Blue Orchidea', i cili u inaugurua në prani të kreut të KMSH-së, H. Bujar Spahiu dhe anëtarëve të tjerë të kryesisë.

Përmirësimi i pagave, menaxhimi dhe investimi në pronat vakëf ka qenë një prej prioriteteve të kryetarit Spahiu, krahas përkushtimit në aktivitetin fetar të institucionit.

Tjetërsimi dhe përvetësimi i pronave të Komunitetit Mysliman si dhe gjithë institucioneve të tjera fetare, është një plagë e trashëguar nga regjimi komunist, por që vazhdoi edhe gjatë këtyre viteve të demokracisë. Gjë e cila ka sjellë shumë vështirësi për komunitetet fetare.

Por, falë përpjekjeve të drejtuesve të KMSH-së dhe mbështetjes së pa kursyer nga besimtarë dhe donatorë të ndryshëm vitet e fundit, me ndihmën e Zotit, gjërat po zhvillohen pozitivisht.

Kryetari Spahiu u lut që ky investim t'i shërbejë rikthimit të traditës së hershme të vakëfeve në vendin tonë, funksioni parësor i të cilave është kontributi për të rritur cilësinë e shërbimit fetar në vend.

I gjithë procesi për vënien në efikasitet të këtij vakëfi është ndjekur nga Drejtoria e Pronave.

Hotel Blue Orchidea është një hotel me standarde hallall dhe shërbim bashkëkohor.







aktivitete

gushit



Rektori i ri i KU “Bedër” viziton KMSH-në

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një vizitë kortezie Rektorin e ri të Kolegjit Universitar “Bedër”, Prof. Dr. Gjergj Sinani, i cili shoqërohej edhe nga bashkëpunëtorë të tij.

Kjo vizitë vjen në kuadër të zgjedhjes së Prof. Sinanit si Rektor i KU “Bedër”, institucion i arsimit të lartë i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

Gjatë kësaj vizite, Kryetari Spahiu, i uroi rektorit të ri suksese në drejtimin dhe përmbushjen e përgjegjësisë institucionale në fushën e arsimit të lartë si dhe i garantoj atij mbështetjen e plotë nga institucioni që ai drejton.

Nga ana e tij, Prof. Sinani, shpalosi vizionin të cilin synon të implementoj në drejtimin e Kolegjit Universitar “Bedër” në vitet në vijim.

Më tej biseda u fokusua në vitin e ri akademik.



sl

aktivitete

ntator

Ambasadori i Republikës së Çekisë në Shqipëri, z. Karel Urban viziton KMSH-në

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim kortezie, Ambasadorin e Republikës së Çekisë në Shqipëri, z. Karel Urban.

Gjatë këtij takimi, Kryetari Spahiu, e njohu ambasadorin Çek me historikun e institucionit, organizimin e tij dhe mbarëvajtjen e jetës fetare të vendit.

Ndërsa z. Urban, pasi shprehu falënderimet e tij për mikpritjen, vlerësoi kontributin që jep KMSH si faktor në shoqërinë shqiptare.

Kryetari Spahiu, e njohu Ambasadorin edhe me një sërë veprimtarish konkrete të institucionit në fushën e dialogut dhe harmonisë ndërfaqetare, arsimit, kulturës dhe përgjegjësisë sociale ndër vite.

Takimi ndërmjet dy krerëve vijoi më tej në formën e një bashkëbisedimi të lirë.



Përfaqësues të Shoqatës Mirënjohja vizitojnë KMSH-në

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim, Mubarek Dusririj- nëndrejtor i projekteve për Ballkanin i shoqatës kuvajtiane, dega 'mëmë' e Sh. Mirënjohja, dhe z. Valid Salih.

Miq të nga Kuvajti u shoqëruan nga drejtuesi i Shoqatës Mirënjohja, dega Shqipëri, z. Samed Shehu dhe përfaqësues të tjerë.

Gjatë takimit u diskutua ecuria e projekteve të përbashkëta dhe u ra dakord për të intensifikuar bashkëpunimin edhe në të ardhmen.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ka bashkëpunim shumëvjeçar me Shoqatën Mirënjohja.





Zhvillohet trajnimi i parë shkencor me rreth 100 imamë nga myftinitë Tiranë dhe Elbasan

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë zhvilloi Trajnimin e Parë Shkencor Fetar në bashkëpunim me Ministrinë e Çështjeve Fetare të Arabisë Saudite.

Në ceremoninë e hapjes, njëkohësisht edhe ditën e parë të trajnimit, ishin të pranishëm H. Bujar Spahiu, Kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Amir al-Anezi, Atasheu Fetar i Mbretërisë së Arabisë Saudite në Bosnje, Dr. Fehd el-Fuhejd, profesori trajnues i seminarit, Myftiu i Tiranës, Lauren Luli, si dhe imamë, hoxhallarë, muezinë të shumtë të Myftinisë Tiranë dhe Elbasan.

Në fjalën e tij hapëse, Kryetari Spahiu, pasi ju uroi të pranishmëve mirëseardhjen në këtë trajnim fetar tre ditor, tha se bashkëpunimi jonë i ngushtë sa i përket çështjeve fetare, aspektit të përgatitjes së kapaciteteve dhe infrastrukturës, është tregues i një rëndësie të veçantë të marrëdhënieve midis dy vendeve tona.

Më tej, ceremonia e hapjes vijoi me fjalën përshëndetëse të Atasheut Fetar të Mbretërisë së Arabisë Saudite në Bosnje, z. Amir al-Anezi, i cili vlerësoi lart bashkëpunimin e deritanishëm me KMSH-në, bashkëpunim i cili është fryt i punës së nisur që në vitin 2019 dhe që synon të konkretizohet edhe më tej në të ardhmen me zhvillimin e konferencave, konkurseve të Kuranit, etj.

Në ceremoninë e mbylljes së këtij trajnimi, e cila u zhvillua ditën e djeshme, u shpërndanë edhe certifikatat e pjesëmarrësve për të pranishmit në trajnim nga Kryetari Spahiu, Atasheu Amir al-Anezi dhe Dr. Fehd el-Fuhejd.







Çelet zyrtarisht viti i ri shkollor 2022-2023

Me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, ishte i pranishëm në ceremoninë e çeljes në Medresenë e Tiranës, ku përpos tij në këtë ceremoni ishin të pranishëm Drejtori i Medresesë, z. Ndrëçim Gjimi, stafi pedagogjik i këtij institucioni arsimor, familjarë dhe nxënësit e ciklit fillor dhe atij të mesëm.

Në fjalën hapëse, Drejtori i Medresesë, z. Gjimi, u shpreh entuziast në fillimin e një viti të ri shkollor duke uruar të gjitha palët për sa më shumë suksese dhe mbarësi, si dhe shprehu angazhimin e tij personal dhe institucional për mbarëvajtjen e një viti sa më të rregullt e frytdhënës.

Ndërsa Kryetari Spahiu, pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, parashtroi rëndësinë e medresesë si një institucion i veçantë arsimor, duke qenë se i formon brezat e rinj jo vetëm me dije shkencore por i pajis ata edhe me besimin në Krijuesin e Gjithësisë.

Më tej ai uroi të gjitha palët e përfshira në procesin e edukimit për më shumë suksese dhe arritje në këtë rrugëtim.

Pas përfundimit të ceremonisë së çeljes së këtij viti të ri shkollor, nxënësit e medresesë vijuan me shpërndarjen nëpër klasat përkatëse ku edhe filluan ditën e parë të shkollës për këtë vit.



Ixhtihadi, domosdoshmëri e kohës sonë - mënyrat, kushtet, personat kompetentë dhe nevoja që kemi për të

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, mori pjesë në konferencën ndërkombëtare me temë “Ixhtihadi, domosdoshmëri e kohës sonë - mënyrat, kushtet, personat kompetentë dhe nevoja që kemi për të”, e cila u organizua nga Ministria e Vakfeve e Egjiptit, nën kujdesin e Presidentit të Republikës së Egjiptit, z. Abdulfetah el-Sisi, në datat 24-25 shtator, me ftesë zyrtare të Ministrisë Egjiptiane të Vakfeve, Mohamed Mokhtar Xhuma.

Si një ndër krerët fetarë pjesëmarrës, kryetari Spahiu mbajti një fjalë përshëndetëse ku foli për rolin e pazëvendësueshëm të ixhtihadit në rrethin e besimtarëve dhe rëndësinë e institucionalizimit të tij.

Një çështje tepër e rëndësishme që u trajtua në këtë konferencë ishte edhe mjedisi.

Z. Spahiu gjithashtu u bëri thirrje të gjithë besimtarëve myslimanë anekënd botës për këtë çështje mjaft të ndjeshme dhe aktuale siç është ajo e përkujdesjes për mjedisin dhe ruajtjes së natyrës që Zoti na ka falur.

Gjatë konferencës në fjalë, kryetari zhvilloi takime me kryetarë komunitetesh myslimane dhe ministra të çështjeve fetare nga shumë vende të botës, si: Ministrin e Çështjeve Fetare të Egjiptit, Mohamed Mokhtar Xhuma, zëvendësin e Imamit të madh të Al-Az'har, Muhammed Edduvejni, Ministrin e Çështjeve Fetare të Mbretërisë së Arabisë Saudite, Reisul Ulema H. Hfz. Shaqir ef. Fetai i RMV, etj.







Një delegacion shtetëror nga Indonezia viziton KMSH-në

Kryetari i KMSH, H. Bujar Spahiu, priti në një takim zyrtar një delegacion shtetëror nga Indonezia.

Delegacioni kryesohej nga Zëvendës Kryetari i Asamblesë Konsultative të Republikës së Indonezisë, Dr. H. Muhammad Hidayat Nur Wahid, së bashku me, Sh.T.Z. Iwan Bogananta, Ambasadori i Indonezisë dhe, z. Sukamta Mantamiharja, z. Johan Rosihan, z. Abdul Hakim, Anëtarë të Asamblesë Konsultative të Republikës së Indonezisë si dhe znj. Yeti Oktaviani, staf.

Kryetari Spahiu e cilësoi këtë vizitë si një etapë të re në marrëdhëniet midis dy vendeve, jo vetëm në aspektin e shkëmbimeve parlamentare, në kuadër të së cilës delegacioni vizitoi Shqipërinë, por edhe në ngritjen e forcimit të bashkëpunimit edhe me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë.

Kryesuesi i delegacionit dhe anëtarët që e shoqëronin vlerësuan rolin e rëndësishëm që luan Komuniteti Mysliman i Shqipërisë në përcimin e mesazhit fetar të besimtarët, dhe veçuan lart harmoninë e dialogun ndër fetar në vendin tonë.

Ata shprehën interesin e tyre mbi potencialet që ofron KMSH në kuadër të intensifikimit të bashkëpunimit mes Indonezisë dhe Shqipërisë.



aktivitete

tetor

Imami i Qabes së Madhnueshme viziton KMSH-në

Imami i Qabes, Hirësia e Tij, dr. Abdullah Avad el-Xuheni dhe delegacioni që e shoqëruan zhvilluan takimin zyrtar në selinë e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, ku janë pritur nga kryetari, H. Bujar Spahiu dhe bashkëpunëtorët e tij.

Kryetari Spahiu shprehu mirënjohjen e tij imamit të nderuar që iu përgjigj ftesës për të vizituar vendin tonë.

Imami nga ana e tij ka falenderuar Kryetarin për ftesën dhe është shprehur i lumtur për këtë vizitë dhe mundësinë që iu dha për të bashkëbiseduar me besimtarët shqiptar në xhami të ndryshme të vendit, duke nisur nga sonte në Xhaminë Et'hem Beu.









Certifikohen studentët e parë të Institutit të Studimeve Islame “Hafiz Sabri Koçi”

U zhvillua në ambientet e KU “BEDER” ceremonia e çertifikimit të studentëve të parë të Institutit të Studimeve Islame të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

I pranishëm në këtë ceremoni ishte kreu i KMSH, H. Bujar Spahiu, imami i Qabes, Hirësia e Tij, dr. Abdullah Avad el-Xuhuheni, anëtarë të kryesisë së KMSH, myftinj dhe imamë.

Kryetari Spahiu gjatë fjalës së tij iu uroi suksese studentëve të çertifikuar dhe shprehu besimin e tij që ata do të jenë përçues të vyer të fesë të besimtarët në xhamitë ku shërbejnë.


Imami i Qabes ndau me të pranishmit përvojën e tij si imam në Qaben e bekuar. Ai gjithashtu vlerësoi punën dhe misionin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë me të gjitha organet në varësi për kontributin e çmuar që japin në përçimin e drejtë dhe pastër të mesazhit të islamit të besimtarët.

Në fund z. Spahiu dhe imami dr. Abdullah Avad el-Xuhuheni ndanë çertifikatat për studentët që sapo kanë përfunduar kursin.









Çaste nga vizita e imamit të Qabes, dr. Abdullah Avad el Xuheni në myfitni dhe xhami të ndryshme të vendit

Gjatë vizitës zyrtare që zhvilloi në vendin tonë, imami i Qabes së Madhnueshme, dr. Abdullah Avad el-Xuheni, vizitoi disa myftini të ndryshme si dhe mbajti ligjërata në xhamitë përkatëse.











Fetvaja dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm

Nën kujdesin e Presidentit të Republikës Arabe të Egjiptit, SH.T.Z. Abdel-Fattah al-Sisi, dhe organizimin e Myftinisë së Egjiptit, u zhvillua konferenca ndërkombëtare me titull: “Fetvaja dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm”.

Kjo konferencë, e zhvilluar në Kairo në datat 17/18 Tetor, mbledhi së bashku studiues, akademikë, përfaqësues të institucioneve fetare dhe përfaqësues politikë nga 91 vende të ndryshme të botës.

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, mori pjesë në këtë konferencë me ftesë të posaçme nga Myftiu i Egjiptit, Dr. Shawki Allam, me të cilin ai zhvilloi edhe një takim, ku diskutuan mbi pikëpamje të ndryshme të marrëdhënies institucionale mes dy palëve.

Gjatë punimeve të kësaj konference, Kryetari Spahiu, zhvilloi takime edhe me personalitete të tjera pjesëmarrëse, ndër ta edhe me Myftiun e Bosnjes, Husein ef. Kavazovic.










Mbrëmje fetare kushtuar Profetit Muhamed (a.s)

Momente nga mbrëmja fetare kushtuar Profetit Muhamed (a.s.) (Mevludi) në xhaminë Et'hem Beu.

Të pranishëm për të ligjësuar mbi aspekte të ndryshme të jetës dhe veprës së Profetit tonë të dashur, ishin; Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, imami i xhamisë, Elton Karaj si dhe imamët Munir Salkurti, Erjol Haxhiu, Abdullah Ziba, hafizi Enes Hyka dhe muezinët Osman Kabili dhe Ahmed Shehi.

Gjatë mbrëmjes fetare, e cila u zhvillua fill pas namazit të Akshamit, u mbajtën ligjëratat rreth jetës dhe veprës së Profetit (a.s.) nga kryetari dhe imamët, u këndua Kuran dhe pjesë nga mevludi gjithashtu.





Dhurohen paisje spitalore për për spitalet publike dhe stafet përkatëse në Elbasan, Cërrik, Gramsh, Dimal

Në kuadër të projekteve humanitare të shumta në mbarë vendin, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, me mbështetjen e organizatave “Swiss Barakah Charity” me qendër në Zvicër dhe “Marionnaud” me qendër në Francë, dhuruan 4 pajisje eko-skaner (në gjendje optimale pune) dhe më shumë se 40 mijë maska të cilësisë së parë, për spitalet publike dhe stafet përkatëse në Elbasan, Cërrik, Gramsh, Dimal (Ura Vajgurore).

Në këtë ceremoni gjithashtu ishin të pranishëm Myftiu i Elbasanit, z. Agim Duka, Myftiu i Peqinit, z. Armand Islami, Myftiu i Gramshit dhe njëkohësisht koordinatori i këtij projekti, z. Ermir Gjana, Kryetari i Bashkisë së Elbasanit, z. Gledian Llatja, Kryetari i Bashkisë së Cërrikut, z. Andis Salla, Kryetari i Bashkisë së Gramshit, z. Klodian Taçe, si dhe drejtorët e spitaleve përfituese.

Në fjalën e tyre, krerët e institucioneve vendore të këtyre rretheve, shprehën falenderimet e tyre për institucionin e KMSH-së që bëri të mundur koordinimin e këtij projekti dhe dy organizatat ndërkombëtare që dhuruan pajisjet.

Pas ceremonisë së dorëzimit, këto pajisje u shpërndanë në spitalet e sipërpërmendura ku u morën në dorëzim nga stafet përkatëse për t'u vënë në shërbim të qytetarëve.



Zhvillohet mbrëmje fetare në Myftininë e Peshkopisë

Çaste nga mbrëmja fetare e zhvilluar në Myftininë Dibër, ku ishin të pranishëm Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Nënkryetari, z. Taulant Bica, Myftiu i Dibrës, z. Muis Kurtulla, z. Blerim Lazimi, mësues në qarkun e Dibrës, si dhe hafizi Enes Hyka.

Menjëherë pas laximit të disa ajeteve nga Kurani Famëlartë, të sjella për të pranishmit nga hafizi, të lartëpërmendurit ndanë me besimtarët e pranishëm aspekte të ndryshme kushtuar lindjes dhe përkujtimit të Profetit Muhamed (a.s).

Në fund të kësaj mbrëmjeje, besimtarët e pranishëm u bënë pjesë e koktejlit me ujë zezë të organizuar me këtë rast.





n

aktivitete

mentor

Zhvillohet forumi ndërkombëtar: “Lindja dhe perëndimi për bashkëjetesën njerëzore”

Pjesë e këtij organizimi ndërkombëtar ishin studiues, personalitete politike dhe liderë fetarë nga e gjithë bota, ndër ta edhe Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu dhe z. Sami Shiba, Ambasadori i Shqipërisë në Arabinë Saudite.

Qëllimi kryesor i këtij forumi, i cili u zhvillua në Mbretërinë e Bahrejnit, mes datave 3 dhe 4 Nëntor 2022, ishte adresimi dhe zgjidhja e problematikave prej të cilave vuan shoqëria njerëzore sot.


Të pranishëm në sesionin përmbyllës të forumit, ishin vetë Mbreti i Bahrejnit, Hamad bin Isa al Khalifa, Shejhul Al-Az'harit, Ahmed al-Tajib dhe Papa Françesku i Vatikanit.

Në fjalën e tij, Mbreti i Bahrejnit, theksoi prezencën e dy liderëve fetarë të sipërpërmendur si të një rëndësie të veçantë, ç'ka e pasuroi edhe më tej këtë forum dhe gjetjet e tij.

Pas tij, ishte radha e Shejh Al-Az'har, Ahmed al-Tajib, të ndante me të pranishmit fjalën e tij, ku shprehu vlerësim të veçantë për mbretin e Bahrejnit, jo vetëm për pjesëmarrjen në këtë forum por edhe për përkujdesjen e mbarëvajtjes së tij.

Ky sesion vijoi më tej me fjalën e Papa Françeskut, i cili vuri theksin në dy blloqet kryesore, Lindjen dhe Perëndimin, si dy territore për të cilat ne të gjithë duhet të kontribuojmë në forcimin e urave aktuale të komunikimit e bashkëpunimit, si dhe në gjetjen e formave të reja të kontributit në rrugën e paqes dhe stabilitetit shoqëror.

Forum i vijoi më tej me pika të tjera të sesionit përmbyllës.









Globalizmi i Konflikteve dhe Universalizmi i Paqes: Kërkesat dhe Partneritetet

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, ndodhet në Abu Dabi të Emirateve të Bashkuara Arabe, ku me ftesë zyrtare të Shkëlqesisë së Tij Abdullah bin el-Shejkh el-Mahfudh bin Bejah, Kryetar i Forumit të Abu Dabit për Paqen dhe Kryetar i Këshillit të Emirateve për Fetvanë, po merr pjesë në forumin e organizuar nga ky institucion, me temë: “Globalizmi i Konflikteve dhe Universalizmi i Paqes: Kërkesat dhe Partneritetet”.

Ky aktivitet u zhvillua nën kujdesin e veçantë të Shkëlqesisë së Tij, Abdullah bin Zajed al-Nahjan, Ministër për Punët e Jashtme dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar në EBA.

Në këtë forum morën pjesë personalitete politike dhe fetare nga e gjithë bota arabe e më gjerë, të cilët gjatë fjalimeve të tyre kanë bërë thirrje për paqe dhe bashkëjetesë ndërfetare e njerëzore në mbarë botën dhe ndëprerjen e menjëhershme të konflikteve pamvarsisht se ku ndodhin ato.

Gjatë punimeve të këtij forumi 3-ditor, 8-10 nëntor, z. Spahiu, krahas pjesëmarrjes në sesionet e tij, zhvilloi njëkohësisht edhe takime me krerët më të rëndësishëm fetarë islamë të Lindjes së Mesme dhe më gjerë, si dr. Abdullah bin Bejah, kryetar i Forumit, dr. Muhamed bin Abdulkerim el-Isa, Sekretar i Përgjithshëm i Ligës së Botës Islame, etj.





Kryetari Spahiu viziton Këshillin Botëror të Komuniteteve Myslimane

Gjatë qëndrimit në Abu Dabi, Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu, u takua me H.E. Ali Rashid Al Nuaimi, Kryetar i Këshillit Botëror të Komuniteteve Myslimane.

Nuaimi mban një sërë detyrash të larta kombëtare dhe ndërkombëtare si, Kryetar i Këshillit Botëror të Komuniteteve Myslimane, Kryetar i Bordit të organizatës së Ekselencës kundër Ekstremizmit të dhunshëm Al-Hedayah, Anëtar dhe zv. Kryetar i Bordit Ekzekutiv të Unionit Parlamentar Ndërkombëtar në Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Kryetar i Delegacionit Parlamentar dhe i Çështjeve të Mbrojtjes, të Brendshme dhe të Jashtme pranë Këshillit Kombëtar Federal.

Gjatë takimit u bisedua për bashkëpunimet e shkëlqyera që Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ka patur me organizmat që drejtohen prej tij, veçanërisht në kuadër të Këshillit Botëror të Komuniteteve Myslimane dhe atë të Organizatës kundër Ekstremizmit.

H.E. Ali Rashid Al Nuaimi shprehu falenderimet dhe vlerësimet më të mira për KMSH dhe shprehu gatishmërinë që bashkëpunimi ndër-institucional do të vazhdojë të shtrihet edhe në fusha të tjera në të ardhmen.



Një delegacion nga Bashkësia Islame e Kosovës dhe Maqedonisë vizitojnë KMSH-në

Kryetari i KMSH, H. Bujar Spahiu, priti për vizite një delegacion nga Bashkësia Islame e Kosovës dhe Bashkësia Islame e Maqedonisë së Veriut, me përfaqësues z. Ramadan Shkodra dhe prof. Jusuf Zimneri.

Përveç projekteve të përbashkëta në të ardhmen, biseda në këtë vizitë u fokusua në përmbylljen e punës disa vjeçare të veprës “El-Ihtijar li Ta’lilil Muhtar”, vepër e cila është përkthyer dhe redaktuar në bashkëpunim me të tre Komunitetet Myslimane (Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Bashkësia Islame e Kosovës dhe Bashkësia Islame e Maqedonisë së Veriut).

Pas Kolanës “Zani i Naltë” dhe librit “Ilmihal i zgjeruar”, vepra në fjalë me 4 vëllime në fushën e Fikhut Hanefi, është projekti më i madh i të tre Komuniteteve respektive. Kryetari u shoqërua në këtë takim nga Drejtori i Kulturës, z. Dorian Demetja.





Kryetari Spahiu pret në një takim titullarët e medreseve të vendit

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një vizitë titullarët e medreseve të vendit, përkatësisht z. Ndiriçim Gjimi, Drejtor i Medresesë Tiranë, z. Kujtim Dervishi, Drejtor i Medresesë Shkodër, z. Neriman Gjinali, Drejtor i Medresesë Durrës dhe z. Ardit Dragoti, Drejtor i Medresesë Elbasan.

Ky takim vjen në kuadër të vlerësimit me çertifikatë të nxënësve maturante të medreseve të cilët kanë hyrë në kategorinë e ekselencës, duke fituar kështu medalje të artë të dhënë nga Kryeministria e Shtetit Shqiptar për vitin 2022.

Prezentë në këtë takim, në selinë e KMSH-së, ishin edhe vetë studentet e lartpërmendura, të cilat u vlerësuan me çertifikatë dhe një vlerë financiare simbolike.

Në fjalën e tij, Kryetari Spahiu, u shpreh krenar me arritjet e nxënësve të medreseve, duke theksuar kontributin e stafit pedagogjik.

Ndërsa drejtuesit e medreseve të pranishëm në këtë takim shprehën falenderimet e tyre për organizimin e kësaj pritjeje. Në fjalën e tyre ata vlerësuan faktin që KMSH u kushton një rëndësi të veçantë dhe i mbështet vazhdimisht këto institucione arsimit. Nxënësët fituese të medaljeve të arta i përkasin dy Medresesë së Tiranës dhe një Medresesë së Durrësit.





d

aktivitete

hjetor

Zhvillohet mbledhja e 6-mujorit të dytë e Këshillit të Përgjithshëm të KMSH-së

U zhvillua në ambientet e Medresesë së Tiranës mbledhja e zakonshme e Këshillit të Përgjithshëm të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

Mbledhja u hap me lexim Kurani nga Myftiu i Fierit, z. Mikel Hazizolli.

Më pas, fjalën e mori drejtori i kabinetit, z. Ejup Lila, i cili bëri hapjen e rastit dhe i dha fjalën Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu.

Kryetari Spahiu bëri një përmbledhje të 6 mujorit të kaluar, duke cekur disa nga zhvillimet kryesore të institucionit në qendër e në rrethe.

Për të vijuar më tej me fjalën e Kryetarit të Këshillit të Përgjithshëm, z. Islam Hoxha, i cili ndau me të pranishmit raportin e Myftinisë Kamëz dhe Myftinisë Vorë, duke shpalosur për të pranishmit aktualitetin e tyre, si nga ana logjistike po ashtu edhe nga ajo fetare.

Më pas, drejtori i kabinetit, ndau me të pranishmit disa nga aktivitetet kryesore të KMSH-së dhe të kryetarit Spahiu për 6-mujorin e dytë të vitit 2022.

U lexuan vendimet e kryesisë që nga mbledhja e fundit dhe u kaluan për votim nga anëtarët e këshillit.

Mbledhja vazhdoi më tej me nënkryetarin e KMSH-së, z. Taulant Bica, i cili bëri një rezymë të shkurtër në lidhje me institutin e studimeve islame, FRMSH dhe aktivitetet që pritet të organizojë Komuniteti Mysliman i Shqipërisë vitin e ardhshëm në kuadër të 100 vjetorit të themelimit si institucion.









Përmbajtja

Drejtori i ri i Qatar Charity Albania viziton KMSH-në	8
Zhvillohen Frytet e Besimit në Lushnje	10
Përfaqësues të Qatar Charity vizitojnë KMSH-në	12
Kryetari Spahiu pret në një takim Ambasadorin e Hollandës në Shqipëri	14
Bordi i Presidencës së KNFSH-së zhvillon mbledhjen e parë për këtë vit	16
Lançohet Instituti i Studimeve Islame “Hafiz Sabri Koçi”	18
Zv. Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës viziton KMSH-në	24
Zhvillohet konferenca ndërfetare me temë: “Vëllazëria në Humanizëm”	26
Kryetari Spahiu pret në KMSH Kreun e Organizatës “Mirësi për botën”	30
Ambasadorja e Suedise në Shqipëri, znj. Elsa Hastad, viziton KMSH-në	32
Zhvillohet simpoziumi “Kur’ani dhe Njeriu”	34
Përurohet Qendra Kulturore në Barbullush të Shkodrës	36
Kryetari Spahiu pret në një vizitë kortezie Ambasadorin e Kosovës	42
Zhvillohet edicioni i katërt i kampionatit të shahut me shoqatën e të verbërve	44
Akordohen 154 bursa studimi për nxënësit e medreseve	46
Këshilli i Përgjithshëm i KMSH-së zhvillon mbledhjen e parë për 2022-shin	50
Fillade Ramazani në prag të këtij muaji të bekuar	54
Zhvillohet programi fetar “Mirë se vjen o Muaj i Bekuar”	56
Lançohet fushata e bamirësisë në ndihmë të mbi 5.500 familjeve në nevojë	60
Zhvillohet tribuna fetare me temë: “Mirë se vjen Ramazan” në xhaminë e qendrës së Koplikut	62
Swiss Barakah Charity vizitë në KMSH	66
KMSH dekoron me titullin “Hafiz Ali Korça”, Prof. Dr. Ferdinand Gjanën, rektor i KU Bedër	68
Zhvillohet programi festiv në Elbasan kushtuar Muajit të Ramazanit	72
KMSH shtron iftarin e parë të Ramazanit 2022	74
Delegacioni i KMSH-së vizitë në kompleksin e mirënjohur për Botimin e Kuranit “Mbreti Fehd”	78
Shpërndahen 25 ton hurma arabe për agjëruesit në mbarë vendin tonë	80
Ambasadorët e dy vendeve mike si Gjermania dhe Franca vizitojnë KMSH-në	82
Fondacioni “Mirënjohja” dhuron paisje elektronike të ndryshme për myftinitë e vendit	84
Zhvillohet ceremonia e faljes së Fitër Bajramit 2022 në sheshin “Skënderbej”, Tiranë	88
Personalitete e përfaqësues institucionesh urojnë besimtarët për Fitër Bajram	92
Ambasadori i Italisë në Tiranë viziton KMSH-në	96
Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu viziton Papa Françeskun	98
Zhvillohet konferenca ndërkombëtare “Uniteti Islam - Koncepti, Mundësitë dhe Sfidat”	102
Takim pune me qendrën “Hedayah” në Abu Dabi	106
Kryetari Spahiu zhvillon takime të shumta me prijës fetarë nga e gjithë bota	108
Kryetari Spahiu pret në një takim drejtuesit e Medresesë Shkodër	112
Zhvillohen Frytet e Besimit në xhaminë e Botanikut	114
Ekstremizmi Fetar - Pikënisjet Ideologjike dhe Strategjitë e Përballimit	118
Mbyllet fushata e dhurimit të gjakut në ndihmë të fëmijëve talasemikë	120
Niset grupi i parë i haxhinjve nga Shqipëria	122
KU Bedër diplomon brezin e 9-të të studentëve	126
Ceremonia e faljes së Kurban Bajramit në sheshin “Skënderbej”	130
Dhjetëra personalitete urojnë besimtarët për Kurban Bajram	134
Zhvillohet shkolla verore për dhjetëra të rinj nga i gjithë vendi	138
Atasheu Fetar i Mbretërisë së Arabisë Saudite në Bosnje-Hercegovinë viziton KMSH-në	142
Një tjetër vakëf i ri i shtohet fondit të pronave tëKMSH-së	144

Rektori i ri i KU Bedër viziton KMSH-në	150
Ambasadori i Republikës së Çekisë në Shqipëri, z. Karel Urban viziton KMSH-në	154
Përfaqësues të Shoqatës Mirënjohja vizitojnë KMSH-në	156
Zhvillohet trajnimi i parë shkencor me rreth 100 imamë nga myftinitë Tiranë dhe Elbasan	158
Çelet zyrtarisht viti i ri shkollor 2022-2023	162
Ixhtihadi, domosdoshmëri e kohës sonë - mënyrat, kushtet, personat kompetentë dhe nevoja që kemi për të	164
Një delegacion shtetëror nga Indonezia viziton KMSH-në	168
Imami i Qabes së Madhnueshme viziton KMSH-në	172
Certifikohen studentët e parë të Institutit të Studimeve Islame “Hafiz Sabri Koçi”	176
Çaste nga vizita e imamit të Qabes, dr. Abdullah Avad el Xuheni në myftini dhe xhami të ndryshme të vendit	180
Fetvaja dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm	186
Mbrëmje fetare kushtuar Profetit Muhamed (a.s)	190
Dhurohen paisje spitalore për për spitalet publike dhe stafet përkatëse në Elbasan, Cërrik, Gramsh, Dimal	192
Zhvillohet mbrëmje fetare në Myftininë e Peshkopisë	194
Zhvillohet forumi ndërkombëtar: “Lindja dhe perëndimi për bashkëjetesën njerëzore”	198
Globalizmi i Konflikeve dhe Universalizmi i Paqes: Kërkesat dhe Partneritetet	202
Kryetari Spahiu viziton Këshillin Botëror të Komuniteteve Myslimane	204
Një delegacion nga Bashkësia Islame e Kosovës dhe Maqedonisë vizitojnë KMSH-në	206
Kryetari Spahiu pret në një takim titullarët e medreseve të vendit	208
Zhvillohet mbledhja e 6-mujorit të dytë e Këshillit të Përgjithshëm të KMSH-së	212

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë
Aktivitete 2022 / Komuniteti Mysliman i Shqipërisë;
ed. Andrin Rasha, Mehmet Disha. - Tiranë :
Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, 2024
219 f. : me foto; 20x20cm.
ISBN 978-9928-194-92-3
1.Feja islame 2.Institucione fetare

28 - 736 (496.5) "2022"